



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“TelKos” L.L.C.
Numri i Biznesit - 810868995
Drejtor – Enver BERISHA
Operator i Shpërndarjes “TelKos”
Platforma: Kabllore
Prishtinë



V E N D I M

për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes, “TELKOS”, sipas platformës Kabllore, me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2016/01) përcakton rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, pavarësisht nga teknologjia e përdorur.
3. Kandidati “TELKOS” ka aplikuar për licencë të KPM-së, për operatorë të shpërndarjes sipas platformës Kabllore, më datën 23 janar 2020.

Arsyetim

4. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.

5. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
6. Komisioni konstaton se kandidati për licencë për operator të shpërndarjes “TELKOS” i janë ofruar të gjitha aktet nënligjore për aplikim për licencë si: Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2016/01), Rregullore për Tarifën Vjetore për Licencë (KPM-2017/06), dhe Formën për aplikim për licencë të KPM-së, për operator të shpërndarjes.
7. Komisioni vlerëson se kandidati “TELKOS” ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator të shpërndarjes në pajtueshmëri me Nenin 6 të Rregullores KPM-2016/01 dhe të shtojcës së kësaj rregullore, ku përcaktohen Procedurat, Kushtet dhe Kriteret për Licencim.
8. Me Rregulloren KPM-2016/01 nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator të shpërndarjes. Prandaj, Komisioni e KPM-se vlerëson se, një operator i shpërndarjes mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve të përcaktuara me nenin 9 dhe 10 të Rregullores KPM-2016/01, ndërsa, kandidati “TELKOS” ka dorëzuar një listë prej 216 kanaleve, si pjesë e katalogut programor.
9. Kandidati “TELKOS” për operator të shpërndarjes sipas platformës Kabllore, përveç ofruesve të shërbimeve programore të licencuara nga KPM, të përcaktuara me nenin 9 dhe 10 të Rregullores KPM-2016/01, do të ketë të drejtë të bartë në katalogun e tij programor vetëm kanalet televizive për të cilat posedon marrëveshje mbi të drejtën e autorit.
10. Pas pajisjes me licencë të KPM-së, kandidati për operator të shpërndarjes “TELKOS” mund të sigurojë marrëveshje shtesë për bartjen e programeve në platformën Kabllore, dhe mund të zgjerojë katalogun e programeve në të ardhmen. Kandidati “TELKOS” obligohet t’i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja për zgjerim të listës programore, sapo t’i ketë siguruar ato.
11. Komisioni vlerëson se, kandidati “TELKOS” ka dorëzuar aplikacionin e tij në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara me Rregulloren KPM-2016/01 si dhe me Rregulloren e KPM-së KPM-2017/06, për t’u pajisur me licencë të KPM-së për një afat prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi të ripërtëritjes.
12. Komisioni vlerëson se, kandidati për operator kabllor “TELKOS” ka përmbushur kriteret për kualifikim për t’u pajisur me licencë të KPM-së.

Vendim

13. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 28 shkurt 2020 merr vendim që, kandidati “TELKOS” me seli në Prishtinë, t’i lëshojë licencën e KPM-së për operator të shpërndarjes sipas platformës KABLLORE për të ofruar shërbime të programeve në

pajtim me katalogun e ofruar programor sipas marrëveshjeve për të drejtat autoriale të atyre shërbimeve mediale audiovizuale, për të operuar në Republikën e Kosovës.

14. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Muja FERATI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



02.03.2020
datë